

FJALA E DEPUTETES KLOTILDA BUSHKA

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Marrëveshja financiare e paraaderimit është një instrument ndihme financiare që Bashkimi European ia akordon vendit tonë në rrugën drejt integritit në Bashkimin European. Në fakt, ne flasim këtu dhe të gjithë japim pikëpamjet tona se si ky instrument mund ta ndihmojë më shumë Shqipërinë, por qytetarët duhet të kuptojnë se për çfarë bëhet fjalë. Ta themi me fjalë të thjeshta. Rëndësia e kësaj marrëveshjeje, e cila nuk është thjesht një projektligj që ne miratojmë sot, por mbart në vetvete të mira që i shërbejnë publike, interesa që vijnë si të mira për qytetarët, për pronën publike, për administrimin publik, për përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve tanë, do të duhet pa diskutim të jetë e qartë për ta.

Ne jemi Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe, përveç se duhet të mbështesim që sa më shumë fonde të thithen nga ato që Bashkimi European vë në dispozicion të Shqipërisë, për të përshtatur të gjithë veprimtarinë shtetërore dhe të jetës në Shqipëri me standardet më të mira të Bashkimit European, do të na duhet edhe të shohim si rriten kapacitetet në institucionet shtetërore në drejtim të kësaj çështjeje, sa përfitojnë qytetarët shqiptarë dhe çfarë duhet të bëjmë më mirë që të kemi rritje të vazhdueshme në këtë drejtim.

Unë vë re që, nga viti në vit, ne kemi kapacitete të shtuara në kuadër të thithjes së fondeve, vë re që kemi më shumë fonde të përfituara, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e të mirës publike dhe që janë përfituar nga qytetarët, por kemi ende shumë punë për të bërë në këtë drejtim, ndaj dhe e përshëndes krijimin e agjencisë dhe koordinatorin ndërkombëtar për këto fonde, sepse kjo do të harmonizojë programimin, thithjen e fondeve, rritjen e kapaciteteve dhe drejtimin e nevojave atje ku është më prioritet, në mënyrë që ne të ecim në bazë të një plani pune të mirëkoordinuar.

Doja të ndaja me ju sot disa shifra që, në kuadër të monitorimit parlamentar, ne bëmë në Komisionin e Ligjeve, për të treguar se sa është realizuar thithja e fondeve gjatë viteve të kaluara dhe rezulton, në fakt, që për vitet 2014 dhe 2016 i gjithë programi është mbyllur. Ne nuk kemi më mundësi të thithim fonde dhe çfarë është marrë dhe zbatuar, konsiderohet e përfunduar, por nga viti 2017 e në vijim projektet janë në vazhdim dhe kjo u jep mundësi autoriteteve shqiptare të thithin më shumë fonde. Për vitin 2014 kemi përfituar 6 milionë euro dhe kam zgjedhur disa zëra, të cilët mund të jenë të kuptueshëm edhe për publikun, siç është mbështetja financiare për reformën në administratën publike.

Kemi qenë në Kuvend, kemi diskutuar për përmirësimin e shërbimeve publike, për përmirësimin e cilësisë në administratën publike dhe pa diskutim edhe kjo mbështetje financiare e Bashkimit Europian ka ndihmuar në këtë drejtim, sepse Bashkimi Europian vërtet na ka vendosur kushte, kërkon të arrijmë standarde, por nuk është se në këtë proces të bazuar në meritë na lë vetëm.

Na mundëson, përveç ekspertizës, edhe ndihmën financiare, të cilën, po ashtu, do të duhet të jemi të aftë ta thithim sa më shumë të jetë e mundur, në mënyrë që të përfitojmë më shpejt. Në vitin 2015 unë veçoj 13 milionë euro të programeve të PAMECA-s, mbështetje për Policinë e Shtetit, Prokurorinë e Përgjithshme, asistencë teknike dhe pajisje, të cilat kanë përmirësuar performancën e Ministrisë së Brendshme, strukturave të Policisë së Shtetit, koordinimin me Prokurorinë e Përgjithshme dhe agjencitë e tjera në fusha të identifikuar, ku kërkohet mbështetje për përmirësimin e furnizimit me pajisje, teknologji dhe know how.

Në vitin 2016, 12,5 milionë euro janë dhënë për një nga reformat më domethënëse për konsolidimin e shtetit të së drejtës, për reformën në drejtësi në Shqipëri, gjithashtu, edhe për procesin e vetingut. Në vitin 2017, në mbështetje të sektorit të konkurrueshmërisë dhe inovacionit, është një fond i konsiderueshëm, 46,6 milionë euro, të cilat janë dhënë për të nxitur sektorin e turizmit, zhvillimit lokal dhe 6,6 milionë euro për inovacionin.

Pa diskutim, konkurrueshmëria e rajoneve shqiptare do të duhet të rritet dhe këto ndihma financiare nga Bashkimi Europian kanë ndikuar që ne të kemi një tregues pozitiv në këtë drejtim, pasi sot ne kemi ofertë të integruar në turizëm, në territoret tona. Nëse bëjmë një krahasim, nuk kemi nevojë as për shifra, pasi është e dukshme. Investimet në zonat turistike,

rritja e cilësive të ofrimit të shërbimit në zonat turistike janë tashmë tregues që konfirmohen edhe nga frekuentimi më i lartë, çdo vit e më tepër, i vendit tonë nga turistë të huaj. Edhe shifrat e veprimtarisë ekonomike në sektorin e turizmit janë ato që tregojnë se kemi një përmirësim në këtë drejtim. Thithja e fondeve nga Bashkimi Europian nuk është vetëm çështje e një instrumenti të paraaderimit, që është kusht për të gjitha vendet që janë në të njëjtën situatë me ne, por, nga ana tjetër, është një proces që bazohet në meritokraci.

Ne marrim fonde, nëse jemi të aftë t'i thithim dhe t'i zbatojmë drejt ato. Fakti që fondet vijnë në rritje tregon se shteti shqiptar, qeveria shqiptare, institucionet shqiptare i kanë pasur kapacitetet dhe mundësitë ta kenë këtë besueshmëri nga institucionet e Bashkimit Europian, për të përfituar çdo vit rritje fondesh. Sfida jonë është të kemi sa më shumë aftësi thithëse në vijim. Në vitin 2018 janë dhënë 23,4 milionë euro për një reformë po aq të rëndësishme që ka nisur, që është mbështetja e sektorit të ujit. Në vitin 2019 u dhanë 70,65 milionë euro, ndihmë e Bashkimit Europian për përfshirjen sociale. E gjithë reforma për ndihmën e ekonomike është bazuar në kritere objektive, që vërtet paraja të shkojë atje ku janë personat nevojtarë dhe të mos kemi “një të nënës, një të njerkës”, të mos kemi njerëz të cilët janë thjesht anëtarë partish me tesera, apo votues që të përfitojnë edhe nga këto.

Ne kemi arritur, me anë të një reforme gjithëpërfshirëse për mbështetjen sociale, të kemi sot sisteme të cilat bazohen në kushte objektive dhe nuk bëhet fjalë vetëm për ndihmën ekonomike, flitet edhe për përfshirjen sociale në punësim, punësimin e rinisë, barazinë gjinore në punësim dhe politika të tjera, që lidhen me promovimin e forcimit arsimor në arsimin parauniversitar për të gjitha vajzat dhe djemtë, me fokus të veçantë në komunitetet e romëve, egjiptianëve, personave me aftësi të kufizuar dhe kategoritë e tjera të cënueshme.

Nëpërmjet IPA-s 2020, “Bashkimi Europian për shtetin e së drejtës” dha 5 milionë euro kontribut në forcimin e shtetit të së drejtës, nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit, Byrosë Kombëtare të Hetimit, Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe agjencive të tjera përkatëse, me qëllim forcimin e kapaciteteve, ofrimin e besimit, sigurisë dhe mjedisit të sigurt për qytetarët shqiptarë, si dhe në përmirësimin e kapaciteteve institucionale të institucioneve të

pavarura të drejtësisë, që t'i kryejnë detyrat e tyre ashtu siç parashikohet në ligj, ashtu siç edhe kërkohet në kuadër të progresit të programit për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Plani i përbashkët i veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor, gjithashtu, është një program i mbështetur nga këto fonde në vitin 2020, tashmë i përfunduar. “Bashkimi Europian për të drejtat e pronësisë” është një nga reformat më të rëndësishme që janë kryer po në këtë Kuvend, po me nismë të qeverisë shqiptare.

Reforma për të drejtën e pronës, kthimi dhe kompensimi i pronës, si dhe regjistrimi i pronave të mbetura pa regjistruar erdhi si pasojë e një amullie 30-vjeçare me titujt e pronësisë së tokave bujqësore, tokave të paregjistruara, oborreve në përdorim. Bashkimi Europian ka ndihmuar me 5,7 milionë euro dhe, ndërkohë, qeveria shqiptare ka arritur të thithë fonde në këtë drejtim, sepse reforma e pronës është bërë gjithashtu me mbështetjen e ekspertëve më të mirë të Bashkimit Europian, në bashkëpunim me Këshillin e Europës dhe Komisionin e Venecias. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u mbështet me 8,7 milionë euro, një mbështetje e padiskutueshme, e çmuar dhe shumë e rëndësishme për besueshmërinë e procesit të vlerësimit kalimtar, apo atë që quajmë ndryshe “procesi i vetingut”.

Ajo që doja të përmendja për të ardhmen, sepse ne sot po miratojmë instrumentin e paraaderimit, ndihmën financiare për periudhën 2023-2027, ka të bëjë me fishat që vlerësohen të jenë prioritare. Vlera totale e 6 fishave, që unë kam përzgjedhur për t'i përmendur këtu, është 59 milionë euro dhe është një mbështetje për programin e vitit 2023. Bëhet fjalë për: kuadrin institucional të luftës kundër korrupsionit me 3,85 milionë euro; ngritjen e rrjetit të komunikimit të Policisë së Shtetit bazuar në teknologji tetra me 5 milionë euro; qeverisjen lokale, që do të marrë fokus, për të cilën janë programuar 10 milionë euro; mbështetjen për menaxhimin e pyjeve me 13 milionë euro; ngritjen e institucionit të veçantë për pacientët psikiatrikë nën një kufizim lirie me vendim gjykate me 15 milionë euro (bëhet fjalë për institucione të përshtatshme për këtë kategori të të dënuarve); mbështetjen për sigurinë ushqimore, veterinarinë, politikën fitosanitare, vetëm për vitin 2013, me 12,5 milionë euro dhe mbështetja buxhetore për punësimin nga Bashkimi Europian do të jetë 40 milionë euro.

Për të ndihmuar efektet negative të krizës dhe zbutjen e papunësisë, për periudhën 2013- 2027, për programe operacionale do të jenë rreth 241 milionë euro, por nga këto unë do të veçoja: BE-në për ekonominë dhe shoqërinë digjitale 43 milionë euro; për eficiencën energjetike 109 milionë euro dhe për garancinë rinore 69,4 milionë euro, përmes së cilave qeveria shqiptare synon të arrijë objektiva kryesore në lidhje me punësimin, arsimin, aftësimin e të rinjve, pjesëmarrjen e tyre në zhvillimin e vendit. I thashë këto, i përzgjodha, nuk janë të vetmet, pasi për mua kanë rëndësi, sepse janë vënë në dispozicion nga Bashkimi Europian edhe si një nga instrumentet e paraaderimit, por edhe nisur nga besueshmëria që institucionet shqiptare kanë treguar përballë institucioneve të Bashkimit Europian se janë të aftë t'i thithin, t'i programojnë, t'i zhvillojnë siç duhet këto fonde.

Në fund përfituese do të jetë shoqëria shqiptare e cila, në tërësinë e saj, do të unifikohet dhe është në rrugën e vet për të shkuar drejt vlerave të Bashkimit Europian, familjes së të cilës i përkasim, por së shpejti do të duhet të jemi edhe pjesë zyrtare integrale e saj. Faleminderit! Të gjithë kolegët në Komisionin e Ligjeve e kanë votuar me unanimitet këtë marrëveshje dhe besoj se edhe Kuvendi do të japë mbështetjen e tij në tërësi, në votimin e sotëm. Faleminderit!